


BES CONSTRUCTION SH.P.K.

AKTI I THEMELIMIT

Më 27 janar 2025

A handwritten signature in black ink, consisting of a large, stylized 'B' followed by a series of loops and a long, wavy tail.

AKT THEMELIMI

Sot, më 27.01.2025, Dervish Domi, shtetas shqiptar, lindur në Domaj, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal G80314072U (këtu e në vijim referuar si "**Ortaku i Vetëm**"), miratoi këtë Akt Themelimi, si më poshtë:

Neni 1

Themelimi dhe forma ligjore

Ortaku i Vetëm deklaron krijimin dhe themelimin e një shoqërie shqiptare me përgjegjësi të kufizuar, përkatësisht BES CONSTRUCTION SH.P.K. (këtu e në vijim referuar si "**Shoqëria**"), në përputhje me dispozitat e ligjit shqiptar nr. 9901, datë 14.04.2008, "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*" (këtu e në vijim referuar si "**Ligji për Shoqëritë Tregtare**"). Shoqëria do të themelohet për një kohëzgjatje të pacaktuar.

Neni 2

Selia e regjistruar e Shoqërisë


Selia e regjistruar e Shoqërisë është në adresën: Rruga Kombetare Tirane-Durres, Km 6, Ndertesa me nr. Pasurie 3/10/1, Hyrja 1, Kati 2, Zona Kadastrale 2679, Tiranë, Shqipëri.

Neni 3

Objekti i aktivitetit të Shoqërisë

3.1. Objekti i Shoqërisë do të përfshijë aktivitetet e mëposhtme:

- a) ushtrim të veprimtarisë në fushën e ndërtimit, punime ndërtimi, projektme, prodhim materiale ndërtimi, mbikqyrje, kolaudim, etj. Ndërtime civile, shërbimesh, ekonomike, industriale, turistike, bujqesore. Rikonstruksione.
- b) punime të mirembajtjes dhe sinalizimit në rrugë, ndërtim mbi shtresa rrugore. Ndërtim, ujesjelles-kanalizime, kanale, impiante vaditese. Perforcime themeli e punime nëntokesore. Izolime mbi dhe nëntokesore nga ujrat. Themele të vecanta. Ndërtim rrugësh të të gjitha kategorive dhe urash si dhe ndërtime portuale, detare dhe ajrore si dhe rikonstruksionin e tyre, asfaltim dhe veshje me asfaltim. Ndërtim digash, galeri, tunele. Ndërtim vepra kullimi, ujë, impiante vaditese, punime mbrojtje dhe sisteme hidraulike, punime dhe sisteme elektrike. Ndërtim ambiente dhe sistemim gjelberimi, parqe e lulishte. Gërmime dheu, hapje kanalesh, etj me makineri të ndryshme.
- c) tregtimi me shumicë e pakicë, import-eksport i mallrave dhe materiale të ndryshme industriale, ushqimore, bujqesore, blegtorale, makineri e pajisje të ndryshme, pajisje ndërtimi, pajisje elektrike edhe elektronike, pajisje hidraulike, hidrosanitare, elektrike, materiale ndërtimi, mallra të të gjitha llojeve. Prodhimi i këtyre materialeve dhe mallrave dhe tregtimin e tyre, i pjeseve të tyre të këmbimit, brenda dhe jashtë vendit.
- d) prodhim materiale inerte. Prodhim elemente betoni e b/arme të zakonshme-pararendur, gure dekorative.
- e) drejtim laborator për prova, testimin e materialeve të ndërtimit. Realizimi i analizave laboratorike për betone, për vete dhe për të treta.



- f) shoqeri administrimi per administrimin dhe mirembajtjen e prones se perbashket ne godinat e banimit, administrimi i bashkepronesise ne ndertesa.
- g) import-eksport i të gjitha llojeve të materialeve dhe makinerive të ndërtimit.
- h) kryerjen e çdo aktiviteti tjetër të nevojshëm, ndihmës apo plotësues në funksion të objektit kryesor të Shoqërisë.
- i) dhenia me qira dhe nen-qira e ambienteve.

3.2. Në përputhje me legjislacionin shqiptar, për përmbushjen e objektit të lartpërmendur, Shoqëria mund:

- a) të aplikojë dhe të pajiset me një ose të gjitha licencat dhe autorizimet e nevojshme, si dhe të kryejë aktivitete tregtare, financiare, qira apo hipotekore të cilat mund të konsiderohen të dobishme apo të nevojshme për përmbushjen e objektit të Shoqërisë dhe që nuk tejkalojnë në masë aktivitetet kryesore, të cituara me sipër;
- b) të blejë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, interesa/kapital, etj në shoqëri të tjera që kanë objekt (objekti i aktiviteti) të ngjashëm me atë të Shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë saj;
- c) të kryejë aktivitete publikimi, marketingu e reklamimi;
- d) të kryejë aktivitete për shitjen me pakicë apo shumicë të mallrave, pajisjeve siç mund të konsiderohet e përshtatshme;
- e) të kryejë çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm për përmbushjen e objektit të Shoqërisë.

3.3. Shoqëria do të kryejë çdo aktivitet që përfshihet në objektin e saj të aktivitetit dhe/ose që lidhet me objektin e saj.

3.4. Shoqëria do të respektojë të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse dhe standardet më të mira etike, në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 4

Statuti

Ortaku i Vetëm deklaron miratimin dhe zbatimin e Statutit të Shoqërisë. Aktiviteti dhe veprimtaria e Shoqërisë do të kryhen në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe rregullat e detyrueshme të legjislacionit shqiptar.


Neni 5

Kapitali

Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 15,000,000.00 (pesëmbëdhjetë milionë lekë) Lekë, i ndarë në 1 (një) kuotë me vlerë nominale të barabartë me 15,000,000.00 (pesëmbëdhjetë milionë lekë) Lekë, plotësisht i nënshkruar dhe i shlyer, i zotëruar plotësisht nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë:

- Dervish Domi, shtetas shqiptar, lindur në Domaj, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal G80314072U.

Neni 6



Administratori

6.1. Administratori i Shoqërisë është:

- Neritan Domi, shtetas shqiptar, lindur në Domaj, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal J11016085E, i cila ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë para të tretëve me nënshkrimin e tij personal ("**Administratori**").


6.2. Administratori emërohet për një afat në detyrë prej 5 (pesë) vitesh me të drejtë rizgjedhjeje. Ortaku i Vetëm ka kompetencë që të shkarkojë Administratorin nga detyra e tij në çdo kohë dhe për çfarëdolloj shkak që e mendon të arsyeshme.

6.3. Të gjitha detyrimet, të drejtat dhe kufizimet e Administratorit janë të detajuara në Statutin e Shoqërisë.

Akti i Themelimit është hartuar në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqërite tregtare", i ndryshuar.

Ortaku i Vetëm i Bes Construction Sh.p.k.

Dervish Domi



The image shows a handwritten signature in dark ink, which appears to read "Dervish Domi". Below the signature is a large, loopy flourish. To the right of the signature is a blue circular stamp with the text "BES CONSTRUCTION SHPK" in capital letters.